



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

ANIS THODHORJANI

Anis Thodhorjani është diplomuar në Stomatologji në vitin 2013 dhe zotëron gjithashtu një Master në Menaxhim Shëndetësor.

Ai ka shërbyer për 6 vite si Drejtor i Përgjithshëm i Klinikës Stomatologjike Universitare, më pas për 1 vit si Këshilltar i Ministres së Arsimit, dhe aktualisht mban pozicionin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), që prej muajit qershor 2025.

Prej 12 vitesh, z. Thodhorjani ka qenë lektor në fushën e Mjekësisë Dentare në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Ai është gjithashtu anëtar i zgjedhur i Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë.

Z. Thodhorjani është lektor i ftuar në dhjetëra konferenca akademike dhe profesionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ai zotëron gjuhën angleze, italiane dhe greke.